



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Nr. 159 Prot.

Tiranë, më 7/2 /2018

Lënda: Kërkesë për auditimin e llogarive financiare të KLSH-së për periudhën 2002-2017.

Drejtuar: z. Gramoz RUÇI

KRYETAR I KUVENDIT ✓

Z. Erion BRAÇE
KRYETAR I KOMISIONIT PËR EKONOMINË DHE FINANCAT

KUVENDI I REPUBLIKËS SE SHQIPËRISË

TIRANË

I nderuar z. Kryetar i Kuvendit,
I nderuar z. Kryetar i Komisionit të Ekonomisë,

Paraprakisht, më lejoni t'Ju falenderoj për mbështetjen që Kuvendi i Shqipërisë dhe veçanërisht Komisioni i Ekonomisë dhe Financave, i ka dhënë në vijimësi institucionit të KLSH-së, për përmbushjen e detyrimeve kushtetuese e ligjore si dhe të objektivave të zhvillimit institucional.

Duke marrë shkas nga fakti se llogaritë e KLSH-së nuk janë audituar që nga viti 2002 si dhe në vijim të kërkesave të vazhdueshme, që KLSH ka adresuar më duhet t'Ju drejtohem përsëri, duke parashtruar përsa vijon:

- Në nenin 7, paragrafi i katërt, të ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", përcaktohet:

"Kontrolli i Lartë i Shtetit, përgatit çdo vit llogaritë e tij financiare në përputhje me legjislacionin mbi buxhetin. Llogaritë auditohen nga një grup audituesish të pavarur, të përzgjedhur nga Komisioni për Ekonominë dhe Financat dhe të miratuar nga Kuvendi".

Kryerja e auditimit të jashtëm të pavarur në institucionet supreme të auditimit (SAI) cilësohet në standardet ndërkombëtare të auditimit të INTOSAI (ISSAI 20, Parimi 6), po kështu dhe në Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë të 20 Tetorit 2016 "Për vlerësimin e veprimtarisë së KLSH-së për vitin 2015" në të cilën theksohet që: "Kuvendi i Shqipërisë në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe në ushtrim të kontrollit parlamentar duhet të angazhohet që të realizojë auditimin e llogarive financiare të KLSH-së dhe t'i bëjë ato publike".

Ju bëjmë se dije KLSH ka qenë objekt i një procesi rishikimi peer review me objekt "Vlerësimi i pavarësisë (funksionale, organizative dhe financiare) të KLSH-së raporti i të cilit u publikua në Nëntor të vitit 2016. Procesi i vlerësimit u ndërmor nga INTOSAI dhe u realizua nga SAI Austriak. Në këtë Raport nga Grupi i Vlerësimit ndër të tjera theksohet se: "Mundësia e auditimit të veprimtarisë financiare nga ana e Kuvendit është një instrument i rëndësishëm për forcimin e transparencës së KLSH-së".

Konstatohet që Kuvendi nëpërmjet Vendimit nr. 64/2013, datë 26.11.2013 "Për fillimin e procedurave parlamentare për auditimin e veprimtarisë ekonomike të KLSH-së" mbështeti KLSH-në duke përmbushur në këtë mënyrë detyrimin ligjor por pavarësisht sa më sipër kjo iniciativë nuk u materializua.

KLSH shpreh dakortësinë që ky auditim të kryhet edhe nga ekspertët kontabël të organizuar në shoqata të pavarura apo edhe nga njësia e Auditimit të Brendshëm të Kuvendit.

Me bindjen se ky auditim do të përbëjë një vlerë të shtuar për performancën e institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, me lejoni të sjell në vëmendjen Tuaj, që në funksion të finalizimit të këtij procesi është e nevojshme ushtrimi i autoritetit ndaj administratës së Kuvendit, për zbatimin e procedurave ligjore për për zgjedhjen e trupës audituese.

Gjej rastin të konfirmoj dhe të shpreh gadishmërinë, për bashkëpunim të stafit të institucionit me ekipin e audituesve të jashtëm të pavarur, me synim kryerjen me korrektesë dhe profesionalizëm të misionit të auditimit mbi veprimtarinë ekonomike të KLSH-së.

Krahas sa më sipër theksojmë që ushtrimi i funksioneve të mbikëqyrjes parlamentare nëpërmjet kryerjes ushtrimit të auditimeve është shprehje dhe tregues i bashkëpunimit dhe i shërben forcimit të institucionit të KLSH-së, dhe rritjes së rolit në mirëqeverisjen e financave publike.

Përsa më sipër, do të vlerësonim shprehjen e vullnetit nga ana Juaj, për kryerjen e auditimit të llogarive të KLSH-së për periudhën 2002-2017, duke plotësuar Ju si organi më i lartë Kuvendi i Shqipërisë dhe ne si organ suprem auditimi KLSH, një detyrim të përmbajtur në ligjin tonë integral dhe në standardet ndërkombëtare të Auditimit INTOSAI.

me respekt,

Bujar LESKAJ

KRYETAR